**VENDIM**
**Nr. 96, datë 5.2.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 276, DATË 16.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË ORGANIZIMIT, TË STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE STATUTIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", dhe të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

"9. Numri i punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar është, gjithsej, 166 veta.".

2. Në skemën 2, që përmendet në pikën 5, të kreut IV, bëhen këto ndryshime:

a) pozicionet "Specialist (IT)" në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, shfuqizohen;

b) numri i punonjësve të nënndarjes 5.3, "Sektori i Shërbimeve", bëhet 14 dhe numri i punonjësve të ndarjes 5, "Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme", bëhet 22;

c) numri i punonjësve të Zyrës Qendrore të Autoritetit Rrugor Shqiptar bëhet, gjithsej, 112.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**